



PRANUAR MË:

ACCEPTED ON:

PRIMLJENO:

Nr.No.Br.

04-10-2010
02/86

KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË

RREGULLORE PËR TATIMIN MBI PRONËN E PALUAJTSHME (Për vitin 2011)

Shtator -2010

Në mbështetje të Rregullores së UNMIK-ut 2003/29 të datës 5.09.2003, nenit 4.1 dhe Ligjit Nr. 03L/0-40 për vetëqeverisje lokale, Statutit të Kuvendit Komunal të Malishevës në mbledhjen e vet të mbajtur me datë 29.09.10, aprovon këtë:

RREGULLORE MBI TATIMIN NË PRONË

Neni. 1.

1.1. Duke u bazuar në Nenin 5 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/29 baza tatimore do të caktohet si më poshtë:

Sipas Zonave në bazë të vlerës së tregut në m²

Destinimi i objektit	Zona I	Zona II	Zona III	Zona IV
Pronarezidenciale-shtëpi	340€	300€	250€	200€
Prona rezidenciale-banesë	350€	-	-	-
Prona industriale	300€	270€	250€	240€
Prona komerciale	630€	400€	300€	240€
Prona bujqësore	200€	200€	200€	200€
Pronate braktisura	150€	120€	100€	50€
<i>Fushat sportive</i>	<i>80€</i>	<i>80 €</i>	<i>70€</i>	<i>70€</i>

Neni 2.

2.1 Duke u bazuar në vend ndodhjen e pasurisë e cila ndikon dukshëm në vlerën e saj në Komunën e Malishevës janë përcaktuar katër zona të cilat paraqesin ndryshime të theksuara në vlerën e pasurisë.

Neni 3.

3.1. Zona e parë përfshin të gjitha banesat, shtëpi dhe lokale afariste që gjenden përkaj rruget "Adem Jashari", "Skënder Beu", "Imer Krasniqi" dhe "Rilindja Kombëtare" në largësi deri në 200 m nga rrugët kryesore në Malisheve.

3.2. Zona e dytë përfshin të gjithë shtëpitë dhe objektet afariste të cilat janë në brendi të qytetit. Në largësi prej 200 metra jashtë zonës së parë. Si dhe zonën urbane në Banjë dhe zonën urbane në Kijevë.

3.3 Zona e tretë përfshinë fshatrat: Balincë, Tërpeze e Ulet, Carralluke, Drenoc, Kijeve- zona jo urbane, Bubavec, Lubizhde, Mirushe, Dragobil, Astrazup, Maxharre, Bellanice, Banje, Mleqan Llazice dhe Temeqinë.

3.4. Zona e katërt përfshinë fshatrat rurale të Komunës së Malishevës: Guncat, Bardh, Senik, Lladroc, Terpeze, Berishe, Kervasari, Guriq, Pagarushe, Shkoze, Marali, Burim, Gurbardh, Pllaqice, Vermice, Golluboc, Damanek, Bubel, Janqisht, Turjake, Panorç, Llapqevë dhe Shkarashnik

Neni 4.

4.1 Në pajtim me neni 6 të Rregullores së UNMIK-ut, 2003/29 normat tatimore të tatimit në prone për pronën e paluajtshme për vitin tatimor 2010 për Komunën e Malishevës janë siç vijon:

Nr	Lloji i pronës	Norma e tatimit
1.	Prona rezidenciale-shtëpi	0.09%
2.	Prona rezidenciale-banesë	0.09%
3.	Prona industriale	0.10%
4.	Prona komerciale	0.13%
5.	Prona bujqësore	0.07%
6.	Pronatë braktisura	0.05%

Neni 5.

5.1. Pronat të cilat lirohen nga tatimi në prone e të cilat janë të cekura në nenin 7 të Rregullores 2003/29, lirohen nga tatimi edhe në Komunën e Malishevës

Neni 6.

6.1 Shtyrja e pagimit të tatimit në kushte të veçanta mund të bëhet konform neni 15 pika 1 të Rregullores së UNMIK-ut, 2003/29.

Neni 7

7.1 Në pajtim me nenin 10.2 të Rregullorës 2003/29 mbi përgjegjësitë komunale, dhe Udhëzimit Administrativ 11/2003 neni 1. Kryetari i Komunës së Malishevës emëron Bordin e Pavarur për shqyrtimin e ankesave administrative të tatimpaguesve për vitin 2010.

Neni 8.

8.1 Rregullorja e UNMIK-ut, 2003/29 e datës 05 shtator 2003 mbi "Tatimin e Pronës të Paluajtshme në Kosovë" dhe udhëzimet administrative rregullojnë të gjitha çështjet tjera të cilat kanë të bëjnë me tatimin në prone e të cilat nuk janë përfshirë në këtë Rregullore Komunale.

Neni 9.

9.1. Kjo Rregullore hynë në fuqi ditën e aprovimit nga ana e Kuvendit Komunal dhe e njëjta do të zbatohet për vitin 2011.

Më: 24.10.2011

Malishevë

Kryesuesi i Asamblesë Komunale

